

“Strategjia e zgjerimit të Bashkimit Evropian në vendet e Ballkanit Perëndimor”

**EKSPOZE E TEMËS SË MASTERIT  
NGA MIGENA LATIFI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK  
SHKENCAT POLITIKE  
PRISHTINË**

## **EKSPOZE**

Mentor: Prof.Asoc.Dr. Zenun Halili

Bashkimi Evropian është një organizatë e cila si qëllim kryesor ka integrimin e gjithë Evropës në një ombrell të vetme më qëllim të krijimit të një stabiliteti politik dhe ekonomik në Evropë. Integrimi në Bashkimin Evropian është shumë i rëndësishëm për shtetet të cilat kalojnë në fazën e tranzicionit, ku procesin e integritit e shohin si indikator për zhvillimin politik dhe ekonomik të shteteve të tyre. Shtetet e Ballkanit Perëndimor aktualisht janë duke kaluar nëpër faza të rëndësishme të integritit.

Politika e zgjerimit siguron një proces të menaxhuar mirë të anëtarësimit, në mënyrë që zgjerimi të sjellë përfitime të njëkohësishme edhe për Bashkimin Evropian, edhe për vendet që bashkohen. Bashkimi Evropian deri më tash kishte zbatuar strategji të ndryshme të anëtarësimit, varësisht nga vendi apo rajoni të cilit i dedikoheshin. Rendi ligjor i krijuar nga Bashkimi Evropian tanimë është bërë përbërës i rrënjësuar në jetën tonë politike dhe në shoqëri. Çdo vjet, në bazë të Traktateve të Unionit, merren mijëra vendime që ndikojnë vendosmërisht në Shtetet Anëtare të BE-së dhe në jetën e qytetarëve të tyre. Ka kohë që individët më nuk janë thjesht qytetarë të shtetit të vet, qytetit apo rrethit; ata janë edhe qytetarë të Unionit.

Vetëm për këtë arsye, është jashtëzakonisht me rëndësi që ata të jenë të informuar mbi rendin ligjor, i cili ndikon në jetën e tyre të përditshme. Megjithatë, ndërlikueshmëria e strukturës së Unionit dhe rendi i tij ligjor nuk kuptohen aq lehtë. Kjo është pjesërisht për shkak të gjuhës së vetë Traktateve, e cila shpesh është disi e paqartë, me aludime që nuk kuptohen lehtë. Faktor plotësues është edhe mosnjohja e koncepteve të shumta, me të cilat Traktatet mundohen të zotërojnë situatën.

Ky punim përbëhet prej katër kapitujve . Në kapitullin e parë shtjellohet më shumë historiku i zgjerimit të Bashkimit Evropian , për zhvillimet politike në Evropën Jug-lindore , pas rënies së Murit të Berlinit , për procesin e integritimeve evropiane , për zgjerimet dhe për kriteret e anëtarësimit të vendeve në Bashkimin Evropian . Në kapitullin e dytë analizohet Procesi i Berlinit dhe agjendat rajonale , dhe strategjia e Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu flitet edhe për Bashkepunimin Rajonal , për fazat e anëtarësimit dhe procesin e negociatave për anëtarësim , i cili paraqet fazën më të vështirë të një vendi , që dëshiron të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian . Kapitulli i tretë i kushtohet përpjekjeve të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre të integritimeve Euro-Atlantike . Në këtë kapitull gjithashtu jam fokusuar tek orientimet dhe tek statusi aktual i vendeve të Ballkanit Perëndimor , duke analizuar arritjet dhe ngeçjet e secilit vend vec e vec . Ndërsa në kapitullin e katërt e të fundit analizohen më shumë sfidat dhe problemet aktuale me të cilat ballafaqohen vendet e Ballkanit Perëndimor , në rrugëtimin e tyre drejt integritimit në Bashkimin Evropian .

### ***Metodologjia***

Gjatë realizimit të këtij punimi do të shfrytëzojë metoda të ndryshme të hulumtimit si metoden pershkruese, kërkimore dhe analiza e të dhënave të cilat do të na mundësojnë realizimin e njëpunimi cilësor. Metodologjia e përdorur në këtë punim hulumtues është metoda kualitative me të dhëna cilësore ku grumbullimi i të dhënave është bazuar në burime sekondare . Do te perdor libra , artikuj te ndryshem te cilet flasin pikerisht per zgjerimin e Bashkimit Evropian me theks te veqant ne vendet e Ballkanit Perendimor . Të gjitha burimet të cilat do t'i përdorë do të jenë të përfshira në fund tek bibliografia .

**Pyetje hulumtuese :** *Cili është progresi që kanë arritur vendet e Ballkanit perëndimor drejt antarësimit në Be ?*

**Hipoteza 1 :** *Vendet e Ballkanit Perëndimor i kanë plotësuar kushtet dhe janë shumë afër antarësimit në Bashkimin Evropian*

**Hiptoteza 2 :** *Sfide kryesore për vendet e Ballkanit janë korupsioni dhe sundimi i ligjit*

**TETOR, 2021**